

ARIO Platform

Ambassadors and Representatives of
International Organizations Platform



INSTITUTI SHQIPTAR PËR ÇËSHJET PUBLIKE



UNIVERSITETI
BARLETI



INSTITUTI SHQIPTAR PËR ÇËSHJET PUBLIKE



UNIVERSITETI
BARLETI

ARIO

Ambassadors and Representatives of
International Organizations Platform



UNIVERSITETI
BARLETI



INSTITUTI SHQIPTAR PËR ÇËSHJET PUBLIKE

ARIO

Ambassadors and Representatives of
International Organizations Platform



INSTITUTI SHQIPTAR PËR ÇËSHJET PUBLIKE

ARIO

Ambassadors and Representatives of
International Organizations Platform



INSTITUTI SHQIPTAR PËR ÇËSHJET PUBLIKE

Ambassadors and Representatives of International Organizations Platform

KONTEKSTI

Platforma ARIO (Ambassadors and Representatives of International Organizations) është një paltformë apolitike, interaktive, informuesedhekonsultuese e cila ka si target grup studentët në Universitet, dhe jo vetëm. Referuar **Ligjit të Rinisë nr. 75/2019 në Shqipëri**, grupmosha e cila definohet me termin “i/e ri/e” është mes 15 deri në 29 vjeç dhe vetëm përgjatë vitit 2019-2020, numri i të rinjve të cilët jetojnë në Shqipëri është 1,661,365, duke përfaqësuar 23,2% të popullsisë totale.

Edhe pse të rinjtë përfaqësojnë grupin më të madh në shoqëri, ka një perceptim të përgjithshëm se ata janë lënë jashtë fokusit të politikave të qeverive, përgjatë gjithë këtyre viteve. Papunësia mestë rinjve mbetet një problem konstant dhe një sfidë reale për ta. Gjithsesi pavarësisht se janë ndërmarrë disa iniciativa nga ana e pushtetit qendror dhe lokal, sërish mungesa e mundësive të punësimit, mungesa e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës, si dhe mungesa e politikave efçente dhe efektive për promovimin e punësimit rinor ka bërë që Shqipëria të jetë mes vendeve me numrin më të lartë të të rinjve të papunë në rajon.

Platforma ARIO

Ndërkohë nëse i referohemi të dhënave të INSTAT, papunësia mes të rinjve ishte 20.9% në vitin 2019, e dhënë e cila nuk është reflektuar në studime të ndryshme të realizuara nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.

Por, referuar ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës), papunësia e të rinjve në Shqipëri, në vitin 2019, arriti në 32.8%. Ndërkohë, sipas Anketës Kombëtare “Rinia në Shqipëri 2019”, 73% e të rinjve të intervistuar, adresuan papunësinë mes të rinjve si çështjen më shqetësuese për ta. Një e dhënë nga studimi “Rinia Shqiptare 2018-2019”, i kryer nga Friedrich Ebert Stiftung (FES), tregon se 51 % e të rinjve të intervistuar deklaruan se janë të papunë si dhe nuk kanë ndonjë perspektivë konkrete për të gjetur një vend pune.

Papunësia e të rinjve dhe mungesa e mundësive të punësimit, programeve dhe politikave për promovimin e punësimit rinorkane çuar në rritjen e numrit të emigrimit të të rinjve dhe rrjedhimisht ikjessë “trurit”. Në këtë kuadër, një studim i kryer nga Emerging Europe tregon se në rajonin tonë vetëm Shqipëria po vuan nga shkalla e lartë e ikjes së trurit mes të rinjve të mirëarsimuar.

Papunësia mes të rinjve, ikja e trurit si dhe cilësia e Arsimit në Shqipëri përbëjnë disa nga sfidat dhe çështjet më prioritare për të rinjtë (përfshirë studentët). Duke pasur parasysh faktin se probleme të tilla kërkojnë një ndërhyrje të mirëmenaduar, të strukturuar dhe të menjëhershme, ne menduam të krijojmë një platformë e cila të mundësonte ngritjen e një dialogu të strukturuar me qeverinë dhe/ose me përfaqësuesit më të lartë të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, pasi të rinjtë/studentët shpesh përballen me mungesën e mundësive dhe mekanizmave për ta bërë këtë gjë.

Në këtë kuadër, **Instituti Shqiptar për Çështje Publike (AIPA)** dhe **Universiteti Barleti (UniBa)** kanë punuar intensivisht për krijimin e **Platformës ARIO** (Ambassadors and Representatives of International Organizations), e cila është një Platformë e komunikimit të hapur, interaktive, informuese dhe konsultuesemes të rinjve, studentëve dhe Stafit Akademik të UniBa, nga njëra anë, dhe Ambasadorëve dhe Përfaqësuesëve të Organizatave Ndërkombëtare të pranishme në Shqipëri, nga ana tjetër.

QËLLIMI:

Përmes diskutimeve dhe dialogut të drejtpërdrejtë dhe të hapur, Platforma ARIO synon:

- ✓ *Krijimin e një dialogu të strukturuar mes të rinjve dhe Ambasadorëve dhe Organizatave Ndërkombëtare në vend;*
- ✓ *Krijimin e një kuptueshmërie më të mirë të pritshmërive të të rinjve shqiptarë në lidhje me perspektivën e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;*
- ✓ *Krijimin e një kuptueshmërie më të mirë të çështjeve të ndryshme që ndonjëherë shoqëria jonë duhet t'i adresojë dhe trajtojë në një qasje të strukturuar;*
- ✓ *Rritja e ndërgjegjësimit të studentëve tanë për të njohur dhe kuptuar diversitetin kulturor dhe ekonomik që ekziston sot në një botë të globalizuar, madje edhe përtej Bashkimit Europian;*
- ✓ *Rritja e të kuptuarit të Komunitetit Ndërkombëtar që jeton dhe punon në Shqipëri mbi nevojat dhe aspiratat e Rinisë Shqiptare përmes diskutimeve, konsultimeve dhe dialogut të drejtpërdrejtë me ta.*

AKTIVITETETE PLATFORMËS ARIO

AKTIVITETI 1



ARIO Platform

Ambassadors and Representatives
of International Organizations

Organized and supported by:



Platforma ARIO, u lançua në mënyrë të suksesshme, në datë 14 Shtator 2021, me prezencën e të ftuarës së nderit **Ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkëlqesisë së saj, znj. Yuri Kim**. Ky aktivitet u zhvillua në Kampusin e ri të Universitetit Barleti. Ky takim u mirëprit dhe u hap nga Rektorja e Universitetit Barleti, Prof. Dr. Suzana Guxholli.

Ndërkohë, pas një përshkrimi të shkurtër të Platformës ARIO dhe qëllimit që ka, nga Drejtori Ekzekutiv i AIPA, Amb. Gilbert Galanxhi, fjala i'u dha të ftuarës së nderit, Shkëlqesisë së saj, Amb. Yuri Kim.

Përgjatë fjalës së saj, Amb. Kim theksoi se *Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë mbështetur dhe vijojnë të mbështesin Shqipërinë, si një vend aleat i saj, në tre drejtime kryesore që lidhen me Shtetin e së Drejtës dhe Demokracinë; Sigurinë dhe Mbrojtjen; si dhe zhvillimin ekonomik dhe biznesin.*

Gjithashtu, Amb. Kim përgjatë bashkëbisedimit me studentë të pranishëm në këtë aktivitet u shpreh ndër të tjera së Shqipëria ka qenë dhe është një vend European dhe që SHBA do të mbështesë një aleat si Shqipëria në rrugën drejt Integritimit European.

Platforma ARIO do të vijojë **çdo muaj** me zhvillimin e aktiviteteve me Ambasadorë dhe Përfaqësues të Organizatave Ndërkombëtare prezente në Shqipëri.

Për më shumë informacione, ju lutem kontaktoni: **Instituti Shqiptar për Çështje Publike (AIPA):**

Adresa E-mail: director.aipa@umb.edu.al

Numër telefoni: +355 67 70 05 500

Website: <https://aipa.al/>